

ANA LALAJ

**MASAKRA E TIVARIT, TIPAR I DHUNËS USHTARAKE
JUGOSLLAVE NË KOSOVË
MARS-PRILL 1945***

Masakra e Tivarit tanimë ka zënë vend në histori si për nga përmasat e tragjizmit të saj, ashtu edhe për nga motivet mbi të cilat ajo u ndërtua. Për këtë masakër, Katinin e shqiptarëve, kanë folur jo pak studiues, si dhe dëshmitarë të ngjarjes, ndër ta më posaçërisht Zekeria Cana, Muhamet Piraku, Uran Butka, Lefter Nasi etj. Në vlerësimin e përgjithshëm, më shumë se ata, unë nuk kam të dhëna të tjera.

Kur flasim për motive, mendoj se ngjarjen nuk mund ta shkëpusim nga konteksti kohor i pragvendosjes së pushtetit komunist në Jugosllavi. Kudo që janë vendosur diktaturat, ato kanë provuar se për të marrë dhe mbajtur pushtetin çmimi është tepër i lartë. Jo vetëm drejtuesit komunistë ortodoksë si Lenini, Stalini, Mao, por edhe liderë të tjerë të përmendur revizionistë, si Trocki, Zinovievi etj., kanë mbrojtur idenë e terrorizmit, si mjet të paevitueshëm në këtë proces. Luftërat janë çasti më i përshtatshëm për të realizuar qëllime pushteti. Për të mos shkuar larg, kur komunistët hynë në Tiranë, në nëntor 1944, ata morën natën nga shtëpitë edhe 16 nacionalistë të njohur dhe i ekzekutuan. Pse? Vetëm të mos i kishin nëpër këmbë pas luftës. Në maj 1945, pranë fshatit Tezna, Tito urdhëroi asgjësimin e 50 mijë ustashëve kroatë dhe 30 mijë refugjatëve, kryesisht gra e fëmijë, u ekzekutuan brenda pesë ditësh kur ata udhëtonin drejt Sllovenisë, me arsyen e rreshtimit në krah të gjermanëve¹.

Alibia e kolaboracionizmit të shqiptarëve është shfrytëzuar shumë si nga grekët për spastrimin etnik të çamëve, ashtu edhe nga jugosllavët për

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare “Masakra e Tivarit, 1945”, organizuar nga Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Malin e Zi, Ulqin, 29-30 prill 2013.

¹ Misha. Glenny, *Historia e Ballkanit, 1804-1999 (Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha)*, Tiranë: Toena – Instituti i Dialogut & dhe Komunikimit, 2007, f.530.

vendosjen e administratës ushtarake në Kosovë². Në këtë rast, qëllimet politike dhe platformat shfarosëse etnike, thënë ndryshe dhuna politike dhe dhuna etnike, janë shfaqur të lidhura ngushtësisht bashkë dhe i kanë shërbyer njëra-tjetrës. Për hir të së vërtetës, në planet e tyre spastruese, grekëve nuk u mungoi bekimi i misioneve britanike³. Po në Kosovë? Ideologu i spastrimeve etnike Vasa Čubrilović (më tej: Vasa Çubrilloviç) bën faktore pakicat për humbjet e mëdha njerëzore gjatë luftës në Jugosllavi. Dhe për çudi, ai shpreson në mirëkuptimin e aleatëve për një Jugosllavi të spastruar etnikisht.⁴

Pikërisht këtë qëndrim të Aleatëve, sidomos ata britanikë, lidhur me ngjarjen që përkujtojmë, zgjodha për të trajtuar në këtë kumtesë të shkurtër. Tek aleatët britanikë për çështjen e Kosovës shpresonin shumë edhe nacionalistët në Shqipëri, por shpresa e tyre ishte zhgënjim. Midis këtyre dy shpresave të kundërta, duket se Çubrilloviçi kishte më shumë të drejtë. Britanikët vërtet nuk bekuan vendosjen e administratës ushtarake në Kosovë e aq më pak terrorin, siç bënë me Napoleon Zervën, në rastin e çamëve, por ata preferuan *heshijen*, që në këtë rast merrte vlerën e mbështetjes. Aleatët britanikë, si fillim, duket se mbetën të kënaqur me Titon që arritën një qeveri koalicioni midis Komitetit të Çlirimit Kombëtar dhe qeverisë mbretërore në mërgim (1 nëntor 1944) dhe nuk u ndërhyjnë në marrëdhëniet e brendshme në Jugosllavi, përfshirë edhe masakrat në popullsinë shqiptare.

Pika e dytë që dominoi vëmendjen britanike ishte dalja në skenë e planeve për një federatë ballkanike dhe sidomos negociatat intensive

² Lefter Nasi, “Tetë muaj nga historia e popullsisë shqiptare në Jugosllavi”, në: *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi (nëntor 1944 - korrik 1945)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1990, f.407- 427.

³ Ελευθερία Μαντα, *Οι Μουσουλμανοί Τζαμηδες της Ηπειρου, 1923-2000*, Θεσσαλονίκη: 2004, p. 312. (Eleftheria Manta, *Çamët e Epirit, 1923-2000*, Selanik: 2004). Në librin e saj, studiuesja greke E. Manta sjell një dokument të shkruar nga vetë C. M. Woodhouse, me titull “Një shënim për çamët”, 16 tetor 1945, ku, ndër të tjera, thuhet: “Zervas, i inkurajuar nga Misioni Aleat i kryesuar prej meje, (nënvizimi im-AL) i ndoqi ata (çamët) nga shtëpitë e tyre më 1944, me qëllim që të lehtësonte veprimet kundër armikut... Çamët e meritonin atë që morën, por metodat e Zervës ishin shumë të këqija, ose për më tepër, oficerët vartës i dolën nga duart. Rezultati në fakt ishte një zhvendosje e popullsisë, duke shpërngulur një minoritet të padëshirueshëm nga toka greke”.

⁴ Vasa Čubrilović, “The Problem of Minorities in the New Yugoslavia”, *The Truth on Kosova*, Tirana: Encyclopaedia Publishing House, 1993, p. 303.

midis jugosllavëve dhe bullgarëve. Janë dhjetë projekte për këtë federatë, që u shqyrtuan njëri pas tjetrit me idenë e një bashkimi të shpejtë. Britanikët u ndjenë shumë të shqetësuar për mundësitë e bashkimeve njëngjyrëshe. Dokumentet dëshmojnë ndërhyrje intensive britanike tek Stalini, me qëllim ndërhyrjen e tij tek Tito për ta ndaluar këtë bashkim. Dhe ia arritën.

Këto dy pika ishin politikisht të mjafta në arritjet britanike, që ata të shfaqeshin të rezervuar në hapa të mëtejme dhe për çështje të tjera, me pak interes për ta. Sa për shqiptarët, tani gjithnjë e më shumë zuri të flitet për një federatë, ku do të ishte e përfshirë edhe Shqipëria. Ndryshe nga rasti bullgar, për shqiptarët nuk pati as edhe një projekt bashkimi dhe nuk u mor vesh ndonjëherë nëse kur Shqipëria do t'i bashkohej Jugosllavisë, Kosova do të ishte pjesë e Shqipërisë, apo pjesë e Serbisë. Sidoqoftë hapja e kësaj teme largoi vëmendjen nga plebishiti i premtuar shqiptarëve në fillim të luftës, madje nga vetë Tito, sipas parimit të vetëvendosjes.

Këto janë rrethanat kur Tito vendosi në shkurt të vitit 1945, Administratën Ushtarake në Kosovë, që do të thoshte se ai i ishte larguar çfarëdo lloj joshjeje për shqiptarët dhe se do të shtonte veçse represionin. Nën kupolën e Moskës, ai ndjehej i papenguar në veprimet e terrorit, duke e përligjur me gjoja kolaboracionizmin kolektiv gjatë luftës. Britanikët po ashtu ishin të paineduar, pasi vlerësonin se në ndarjen 'fifty-fifty' [50% me 50%] Churchill-Stalin në tetor të vitit të kaluar në Moskë, nuk mund të arrinin më shumë se aq. Qeveria shqiptare, faktor i interesuar për zgjidhje të tjera, ishte krejt e dobët dhe e pamundur të imponohej.

Ky moment ka sjellë në historiografi dilemën "e shiti apo nuk e shiti Enver Hoxha Kosovën", term që në fakt është përdorur edhe nga vetë britanikët. Rreth heshtjes së PKSH për aneksimin e Kosovës – Serbisë, Misioni Ushtarak Britanik në Shqipëri do të shprehej në dy raporte të vetët, në maj 1945. "Fakti që FNÇ, shkruhet në raport, ra dakord për humbjen e këtij rajoni vital me popullsinë e tij mbizotëruese shqiptare konfirmon se si është shitur tërësisht FNÇ te Jugosllavia dhe ka larguar të gjithë elementët nacionalistë, veçanërisht në veri të vendit, dhe akoma më tutje"⁵. Nga ana tjetër, është për t'u mbajtur në konsideratë se shteti i

⁵ *National Archives Records Administration* (më tej: NARA), 1945-1949, Roll 2. 875.01/6-845, British Military Mission ALBANIA. Periodical Report No.101/3, May 22, 1945.

dobët shqiptar nuk mund të ndërmerre aventurën e dështuar, t'i vinte kushte Jugosllavisë. Për shtetin e dobët shqiptar, Shqipërinë komuniste të pasluftës, Jugosllavia ishte mbështetja e vetme.

Masakrën e Tivarit të parët që e kanë regjistruar sigurisht janë vetë serbët. Një numër dokumentesh të arkivave serbe, janë shfrytëzuar nga studiuesi Uran Butka në librin e tij “Masakra e Tivarit”, botuar në Tiranë, në vitin 2011, prandaj do të shmangem të flas rreth tyre. E vetmja çka mund të them është se aty vërehen lehtësisht pasaktësi shifrash të eshalonëve, pasaktësi informacioni, fajësime të shqiptarëve, madje edhe të popullsisë së Shkodrës dhe shfajësime të vetvetes nga ana e jugosllavëve, madje deri në absurd.

Masakra ka tërhequr vëmendjen e britanikëve, të cilët nuk e kanë ndjekur nga afër dhe sesi shqiptarët, serbët po e po, ua kanë fshehur britanikëve të vërtetën. Po sjell këtu një raport të kryetarit të British Military Mission (BMM), gjeneralit Hodgson, që i dërgonte War Office-it, më 26 prill 1945, pas një vizite që kishte bërë në Shkodër. Në këtë raport, ai thotë: “Arrita në Shkodër më 23 prill 1945 ... Ndërsa isha duke shëtitur në qytet, pak kohë pas ardhjes sime, unë pashë, tre grupe të mëdhenj trupash që marshonin, gjithsej 1500 persona. Ata ishin të paarmatosur, shoqëruar nga partizanë jugosllavë të armatosur, dhe vinin në Shkodër prej drejtimit Lindor. Përkthyesi im pyeti një partizan jugosllav për identitetin e këtyre njerëzve. Partizani u përgjigj se ata ishin shqiptarë kosovarë, të cilët kishin luftuar kundër shokëve të tij. Ai besonte se ata ishin në rrugë për Dalmaci.

Më vonë pata mundësi t'i vëzhgoj kolonat nga afër. Burrat ishin të gjithë fshatarë dhe, me sa pashë, ishin duke vuajtur nga një lodhje ekstreme.

Po atë mbrëmje, në darkën e shtruar nga Komandanti Ushtarak, unë pata mundësi të pyesja disa oficerë për subjektin në fjalë. Përgjigjet që mora janë:

a) Komisari i Korparmatës së III, **Beqir Balluku**:

“Ata janë fshatarë malazezë, të cilët po kalonin përmes Shqipërisë për rekrutim në Ushtrinë Jugosllave”.

b) Presidenti i Këshillit Lokal, **Riza Dani**:

“Ata janë shqiptarë nga Kosova, të cilët shkonin si rekrutë në Ushtrinë Shqiptare”.

c) Zv/Presidenti i Këshillit Antifashist, **Hasan Pulo**:

“Ata janë ushtarë të vjetër në Ushtrinë Jugosllave rrugës për në Mal të Zi”.

“Besoj, konkludonte Hodgson në raportin e tij, se deklarata e ushtarit jugosllav ishte më e sakta”. Pra, sipas ushtarit jugosllav, ata ishin shqiptarë, të cilët kishin bashkëpunuar me nazistët dhe tani po udhëtonin për në Dalmaci. Se çfarë do të bëhej me ta, ushtari rojë jugosllav nuk e tha dhe me siguri nuk e dinte. Por për të, ata mijëra shqiptarë nuk ishin të saporekrutuar për në front, por robër, të cilët duheshin mbajtur nën kontroll.

Sigurisht, zyrtarët e lartë shqiptarë ia fshehën edhe ata të vërtetën shefit të Misionit Britanik. Marrëdhënia me britanikët e tillë kishte qenë gjatë gjithë kohës së Luftës, e tendosur dhe e ngarkuar me paragjykime politike. Le të mos harrojmë qarkoren “Shpati”, ku Enver Hoxha urdhëronte të gjithë komitetet e PKSh në rrethe që “të mos lejonin britanikët të fusnin hundët në punët tona të brendshme”⁶. Duket e çuditshme, por të vërtetën e mësojmë në një bashkëbisedim që Mehmet Shehu zhvillon me kinezët në fillim të vitit 1957, dhe u pohon atyre se “në vitin 1945 jugosllavët kanë dashur të kalonin nja 3000 veta që i konsideronin si ballistë nga territori ynë në territorin jugosllav. Duke i shpërndarë nga njëra anë në tjetrën ata kanë ekzekutuar me qindra veta në tokën tonë. Shoku ynë Beqir Balluku që ishte në këtë kohë komandant Korpusi, erdhi natën nga Shkodra dhe i raportoi shokut Enver mbi këto veprime që bënin jugosllavët mbi popullin kosovar”⁷.

Një raport tjetër më të hollësishëm për dhunën ndaj shqiptarëve në Jugosllavi na jep ambasadori britanik në Beograd, Ralf Skrine Stevenson. Në një material prej 10 faqesh dërguar personalisht ministrit të Jashtëm britanik, Anthony Eden, ambasadori informon në detaje për situatën politike në Kosovë dhe në Maqedoninë Veriperëndimore. Pasi pohon se shkak kryesor i Lëvizjes së dobët Nacionalçlirimtare në Kosovë është represioni i shtetit serb ndaj shqiptarëve midis dy Luftërave, ambasadori raporton se në fund të dhjetorit 1944, ndodhi tërheqja e armikut, që përfshinte rreth gjysmën e Divizionit “Skanderbeg SS” që i shoqëronte ata; kurse gjysma tjetër më e vendosur mbeti në Kosovë dhe në malet

⁶ *Public Record Office* (më tej: *PRO*), FO.371/43553.

⁷ *Arkivi Qendror Shtetëror* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi Partisë (më tej: AP) -Marrëdhëniet me Partinë Komuniste Kineze (më tej: MPKK), V. 1957, D. 1.

rreth saj, ku bëri një rezistencë të dëshpëruar kundër partizanëve. Ambasadori raporton për **12 000** shqiptarë që kanë qenë detyruar të deportoheshin me forcë prej Kumanovë, Gjilanit dhe Vranjës për në Banat dhe për një raport amerikan që fliste për rastet e rënda të tifos midis shqiptarëve në Banat. Ambasadori informon se prej Maqedonisë veri-perëndimore kishte shumë raporte për kryengritjen dhe në *mes të marsit 1945*, trupat dalmate së bashku me tanket, kishin kaluar përmes Shqipërisë në rrugën e tyre për në Maqedoni.

Kur ambasadori Stivenson i shkruante këto radhë, ai nuk ishte i bindur “nëse është thyer forca kryesore e rezistencës së armatosur të shqiptarëve”. Sipas tij, deklarimi i bashkimit të Kosovës me njësinë federale serbe, “nuk mund të bëhet në qoftë se qeveria nuk do ta ndjente se thumbi i rezistencës shqiptare ishte hequr”⁸. Koha tregoi se ambasadori britanik kishte të drejtë. Dokumenti që sanksiononte bashkimin e Kosovës me Serbinë, e që i duhej aq shumë qeveritarëve jugosllavë, për ta reklamuar si dëshmi legjitimiteti të pushtetit serb në Kosovë, u bë kur ekzistonte akoma Administrata Ushtarake, dhuna e së cilës me deportime masive, mobilizime me forcë, intriga dhe vrasje, për disa muaj rresht, pothuajse e kishte paralizuar ndjeshmërinë njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës.

Ajo që ndodhi në Kosovë në vitet 1944-1945, lëshon hije dhe mbi formacionet ushtarake dhe shtetin shqiptar të kohës. Një gjë është e qartë, marrëdhëniet shqiptare –jugosllave nuk u kondicionuan nga çështja e Kosovës. Duke folur në Byronë Politike në shkurt të vitit 1973, Enver Hoxha do të deklaronte: “Ne i ndihmuam ata [udhëheqësit komunistë të PKJ- shën.im. A.L.] për çlirimin e popujve të Jugosllavisë, duke bashkëpunuar në vijën e Luftës Nacionalçlirimtare. Në kuadrin e bashkëpunimit me Luftën Nacionalçlirimtare Jugosllave, ndaj së cilës Partia jonë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare kanë mbajtur një qëndrim të drejtë, ne kemi ndikuar në zhvillimin me sukses edhe të Luftës Nacionalçlirimtare në Kosovë”⁹.

Megjithatë po të shohësh me vëmendje dokumentacionin e kohës, vëren se veprimtaria e këtyre formacioneve në Kosovë kishte një vend të

⁸ PRO, FO.371/48090, Ambasadori i SHBA pranë qeverisë jugosllave, në Beograd, i shkruan FO, më 2 prill 1945, telegram nr. 405.

⁹ AQSH, F. 14/AP-Organet Udhëheqëse, viti (më tej: V.) 1973, dosja (më tej: D.) 4.

posaçëm. Madje kjo shprehet qartë në një letër të Fadil Hoxhës, i cili më 25 gusht 1944, në emër të Shtabit Madhor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave kërkon vajtjen e dy brigadave shqiptare në Kosovë sepse “Ardhja e brigadave në këtë terren kishte me i përmbysë planet e okupatorit ..., me e kthye Kosovën nga bazë e reaksionit në bazë lridashëse ... Shkaktarë që Kosova është bërë bazë e reaksionit janë hegjemonistët serbë ... Por shumica e popullit të Kosovës nuk ka besim te PKJ dhe te Shtabi Jugosllav...”¹⁰. Afërsisht të njëjtën gjë pohon dhe gjenerali jugosllav Velebit, i cili i shprehet ambasadorit britanik Stivenson: “Tani, në pjesën më të madhe trazirat kanë kaluar, kryesisht edhe në sajë të bashkëpunimit në shtypjen e kryengritjes me trupat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (më tej: UNÇSH)”¹¹. Pra, duket qartë se kemi të bëjmë me interesa politikë të përbashkët. Beogradi kishte nevojë për prezencën e ushtrisë shqiptare në Kosovë, në ndërkohë që atje u vendos “Administrata Ushtarake”. Tirana kishte nevojë për mbështetje politike, ekonomike etj., duke filluar nga njohja e shtetit komunist shqiptar, njohje që Beogradi e dha pa pritur ende vendimin e Të Mëdhenjve.

Drejtuësit e lartë të UNÇSH gjatë marshimit në Kosovë e viset e tjera në Jugosllavi, synonin të takoheshin dhe me Ushtrinë e Kuqe që kishte luftuar për çlirimin e Beogradit e të marshonin deri në Berlin. Por oficerët e lartë jugosllavë si Apostolski e Teržić i vunë fre kësaj iniciative. Në optikën e tyre, misioni i brigadave shqiptare ishte i destinuar vetëm për në Kosovë e në territoret jugosllave përreth saj. “Gjejmë pengesa për të shkuar në Frontin sovjetik. Nevojitet ndërhyrja juaj e drejtpërdrejtë me anë të Misionit Sovjetik dhe Misionit Jugosllav”, i shkruante nga Beogradi Mehmet Shehu - Enver Hoxhës më 14 prill 1945.

Forcat e UNÇSH u larguan valë - valë nga Jugosllavia. Të fundit u larguan partizanët e Brigadës VI që mbetën në Jugosllavi deri në dhjetor të vitit 1945, pra edhe 7 muaj të tjerë pas çlirimit të Jugosllavisë. Më 16

¹⁰ *Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura*, F. 130, V.1944, D. 141 [130], Bobina 2, Fadil Hoxha dhe Boshko Cakic në emër të Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë për Kosmet i shkruajnë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, më 25 gusht 1944.

¹¹ *PRO. FO 371/48090/R 8181/237/90*. Raport i Ralf Stevenson, ambasadori britanik pranë qeverisë jugosllave në Beograd, dërguar ministrit të Jashtëm, Anthony Eden, nr. 58, më 27 prill 1945.

nëntor 1945, shefi i Shtabit të Përgjithshëm Jugosllav, gjeneral –leitnant Koča Popović, i komunikoi kryetarit të Misionit Ushtarak shqiptar në Beograd, Vasil Andonit, se “Divizionet V dhe VI të hyjnë në tokën shqiptare pasi nuk kanë ku të qëndrojnë më në Jugosllavi”. Disa ditë më vonë, Spiro Moisiu, komisar i UNÇSH, urdhëroi Shtabin e Divizionit V dhe VI, që largimi i partizanëve shqiptarë nga Jugosllavia të bëhej gjatë 2-7 dhjetorit.

Ndërkohë që shqiptarët e Shqipërisë nuk informoheshin për çka po ndodhte në Kosovë dhe me Kosovën, partizanët e formacioneve të UNÇSH që ndodheshin në Kosovë, mendonin me çiltërsi se me luftën e tyre po kryenin një akt patriotik dhe internacionalist.